



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 575/15 Prot.

Tiranë, më 16.02 2023

VENDIM

Nr. 26 dt. 16.02 2023

“PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN PËR FUNKSIONIMIN E
SENATIT AKADEMIK TË UST”

Në zbatim të nenin 33 paragrafi 3, neni 38 gërma d të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, në nenin 20 gërma y të Statutit të UST-së, në nenin 7 të Rregullores së UST-së, si dhe në Memon me nr.482 prot., datë 09.02.2023 të Drejtorisë Juridike dhe Zhvillimit të Kurrikulave “Ndryshimi i nenit 12 pika 2 e Rregullores për Funkcionimin e Senatit Akademik të Universitetit të Sporteve të Tiranës”, Senati Akademik në mbledhjen e datës 16.02.2023,

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimeve në Rregulloren për Funkcionimin e Senatit Akademik të Universitetit të Sporteve të Tiranës (bashkëlidhur këtij vendimi).
2. Ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko- Shkencore për publikimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. AGRON KASA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

**RREGULLORE PER FUNKSIONIMIN E
SENATIT AKADEMIK TË UST**

**Miratuar me Vendim Nr. 36, datë 10.11.2016
të Senatit Akademik të Universitetit të Sporteve të Tiranës**

**Ndryshuar me Vendim Nr. 26, datë 16.02.2023 të Senatit
Akademik të Universitetit të Sporteve të Tiranës**

KREU I

Dispozita të Përgjithëshme

Neni 1

Objekti i kësaj Rregullore është organizimi dhe funksionimi i Senatit Akademik të UST. Çështje të saj janë:

- Zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore në veprimtarinë e Senatit Akademik.
- Organizimi dhe funksionimi i Senatit, i Komisioneve të Përherëshme.
- Bashkërendimi i veprimtarisë me Rektoratin, Fakultetet, Institutin e Kërkimit Shkencor, Bordin e Administrimit, Administratën.

Neni 2

Baza ligjore është Ligji Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës dhe Enteve Publike”; Statuti i UST dhe akte të tjera ligjore e nënligjore.

Neni 3

UST është Institucion Publik i Arsimit të Lartë me karakter mësimor e shkencor. Është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.23 datë 17. 02. 2010 “Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës”, mbi bazën e Akademisë së Edukimit Fizik e Sporteve “Vojo Kushi”.

KREU II

Parimet Bazë

Neni 4

Senati Akademik është organ kolegjial vendimarrës në nivelin e UST. Është organi më i lartë akademik i UST përgjegjes për përmbushjen e misionit të tij.

Neni 5

Anëtarë të Senatit janë përfaqësuesit e zgjedhur nga rradhët e pedagogëve, të studentëve të UST sipas Rregullores së Zgjedhjeve të MAS. Rektori i UST është Kryetar i Senatit Akademik. Mandati i Senatit është 4 vjeçar.

Neni 6

Funksionet e Senatit të UST janë ato që përcaktohen në Ligji Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kerkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe në Statutin e UST, neni 10.

KREU III

Organizimi i Senatit

Neni 7

Senati, me propozim të kryetarit, nga rradhët e tij zgjedh nënkryetarin dhe sekretarin e tij. Si rregull me konsensus ose dhe me shumicë të thjeshtë.

Neni 8

Kryetari, zv.kryetari dhe sekretari përbëjnë Kryesinë e Senatit Akademik. Kryesia kujdeset për krijimin e infrastrukturës së domosdoshme për mbarvajtjen dhe funksionimin normal të veprimtarisë së Senatit.

Neni 9

Senati, për të mundësuar një funksionim sa më efikas, ngre komisione ad-hoc për të trajtuar problem specifike që dalin para UST.

Neni 10

1. Komisionet ad-hoc të Senatit në veprimtarinë e tyre mund të kërkojnë asistencë të Drejtorisë Juridike, të Financës, Administratorit, etj.
2. Komisionet gjatë shqyrtimit të materialeve për përgatitjen për Mbledhjen e Senatit kanë të drejtë të thërrasin për sqarime drejtuesit e organizmave që paraqesin këkesë para Senatit.

KREU IV

Funksionimi i Senatit Akademik

Neni 11

Kryetari dhe Kryesia e Senatit Akademik

1. Kryetari, përvec funksioneve të tjera, drejton mbledhjen e senatit, drejton diskutimet dhe siguron zbatimin e ligjit dhe marrjen e vendimeve të drejta.
2. Nënkyetari dhe sekretari zgjidhen nga rradhët e përfaqësuesve të zgjedhur të pedagogëve.
3. Kryetari mund të shtyjë ose të mbyllë mbledhjen përpara kohe, në rastet kur situata e përlik gjatë veprim. Në këto raste duhet të merret një vendim i arsyetuar, i cili do të pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes.
4. Zëvendësimi i përkohshëm i kryetarit, në mungesë të tij, bëhet nga nënkryetari. Nënkyetari dhe sekretari në mungesë të tyre zëvendësojnë njëri tjetrin.

Neni 12

1. Kryesia, nën drejtimin e kryetarit, mbledhet para çdo mbledhje për të përgatitur Mbledhjen e Senatit. Në këtë mbledhje duhet të jetë i pranishëm edhe drejtori i drejtorisë juridike për mbështetje juridike. Pas detyrave që nxjerr kjo mbledhje, sekretari dhe nënkryetari vihen në lëvizje në zbatim të detyrave që cakton kryesia në këtë mbledhje.
2. Pas përfundimit të mbledhjes së Senatit Akademik, të asistuar nga sekretari dhe nënkryetari, nën drejtimin e kryetarit, Drejtoritë e ndryshme të UST-së sipas fushës së tyre të ekspertizës, angazhohen dhe përgatisin zbardhjen e vendimeve të marra në Senat, në afatin e përcaktuar në këtë rregullore.
3. Kryetari i Senatit ndërmerr veprimet e nevojshme që vendimet e zbardhura ti dergohen elektronikisht anetareve të Senatit.

Neni 13

Kryesia e Senatit, në rastet e shkeljes së etikës dhe rregullores nga anëtarët, mbledhet nga Kryetari pas përfundimit të mbledhjes dhe analizon rastet e këtyre shkeljeve. Kryesia mund të marrë masa administrative ndaj anëtarëve që shkelin etikën me vërejtje dhe me përjashtime nga mbledhjet e senatit me një deri dy mbledhje.

Neni 14

Mbledhjet e radhës.

1. Senati zhvillon mbledhjet e radhës në zbatim të kompetencave të tij sic përcaktohen në Ligji Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kerkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Statutin e UST.
2. Kryetari vendos për datën dhe kohën e mbledhjeve të radhës, përveç rasteve kur vetë organi ka vendosur ndryshe.
3. Senati mbledhet në séancë të zakonshme jo më pak se një herë në dy muaj.

Neni 15

Mbledhjet e jashtëzakonshme

Mbledhjet e jashtëzakonshme thirren nga kryetari, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj.

Neni 16

Thirrja e mbledhjeve

1. Kryetari është i detyruar të thërrasë një mbledhje kur kjo kërkohet me shkrim nga të paktën 1/3 e anëtarëve, duke përcaktuar çështjet për të cilat thirret kjo mbledhje.
2. Lajmërimet për thirrjen e mbledhjeve bëhen brënda 15 ditëve pas paraqitjes së kërkesës nga 1/3 e anëtarëve të paktën 48 orë para datës së thirrjes të mbledhjes.
3. Lajmërimi për thirrjen e një mbledhjeje duhet të tregojë në mënyrë të qartë dhe të detajuar çështjet për të cilat do diskutohet.

4. Senati i mbledhur sipas kësaj kërkesë miraton ose jo çështjet e rendit të ditës me shumicë të thjeshtë votash.

Neni 17

Rendi i ditës

1. Kryetari vendos për rendin e ditës së cdo mbledhjeje. Rendi i ditës duhet të përfshijë ato çështje që i janë propozuar atij nga Rektori, Fakultetet, Instituti i Kërkimit Shkencor, Administrata, si dhe çështje që Rektori i gjykon si të nevojshme për tu trajtuar dhe që janë në kompetencë të Senatit.

2. Rendi i ditës me materialet përkatëse duhet t'i shpërndahet të gjithë anëtarëve, pasi të jenë shprehur komisionet, të paktën 48 orë përpara datës dhe kohës së mbledhjes. Njoftimin dhe shpërndarjen e materialeve e organizon Kryetari Senatit.

Neni 18

Marrja e vendimeve

1. Senati i UST si organ kolegjial vendimarrës merr vendime. Ai merr vendime vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes, përveç rasteve kur të paktën 2/3 e anëtarëve vendosin për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve për çështje që nuk janë në rendin e ditës.

2. Vendimi zbardhet brënda pesë ditëve nga dita e mbledhjes.

3. Vendimi zbardhet në dy kopje. Nje kopje që protokollohet dhe tjetra ruhet pranë rektorit. Informacioni për vendimet sebashku me nje fotokopje te vendimeve i përcillet tre njesive kryesore të UST, Kancelarit të UST dhe sipas permbajtjes se vendimeve organizmave te caktuara.

Neni 19

Thirrja e mbledhjeve në kundërshtim me rregullin

Mbledhja e Senatit Akademik, e thirrur nga Rektori, është e vlefshme edhe kur nuk respektohen procedurat e parashikuara për thirrjen dhe zhvillimin e saj, vetëm në rast se në atë mbledhje marrin pjesë të gjithë anëtarët, që nuk kanë ndonjë pengesë për tu paraqitur, dhe paraprakisht, miratojnë zhvillimin e mbledhjes.

Neni 20

Kuorumi

1. Mbledhja e Senatit është e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.

2. Kur në hapjen e mbledhjes nuk janë të pranishëm shumica e anëtarëve, kryetari vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër, jo më parë se 24 orë pas së parës. Në këtë rast mbledhja është e vlefshme në qoftë se janë të pranishëm së paku gjysma e anëtarëve.

Neni 21

Votimi i detyrueshëm

Anëtarët e senatit që janë të pranishëm në mbledhje janë të detyruar të votojnë (pro, kundër ose abstenim)

Kryetari i Senatit voton i fundit.

Neni 22

Forma e votimit

1. Vendimet merren me votim të hapur.
2. Vendimet që përmbajnë vlerësime mbi sjelljen ose cilësinë e një individi merren me votim të fshehtë.
3. Votimet në Senat mund të bëhen të fsheta kur këtë e kërkon Kryetari ose 1/3 e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

Neni 23

Shumica e nevojshme për të marrë vendime

1. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje përveç rasteve kur me ligj kërkohet një shumicë e cilësuar.
2. Kur kërkohet një shumicë e cilësuar dhe kjo nuk arrihet, kryhet një votim i dytë. Në qoftë se edhe në votimin e dytë do të përsëritet e njëjta situatë, vendimi shtyhet për t'u marrë në mbledhjen tjetër, në të cilën një shumicë e thjeshtë do të ishte e mjaftueshme.

Neni 24

Barazia e votave

1. Në rastet kur rezultati është i barabartë dhe votimi nuk ka qenë i fshehtë, vota e kryetarit është vendimtare.
2. Në rast se votimi bëhet i fshehtë dhe votat janë të barabarta, do të kryhet një votim i dytë. Kur edhe në votimin e dytë ka barazi të votave, vendimi do të shtyhet për mbledhjen tjetër. Në qoftë se në votimin e parë të mbledhjes tjetër do të kemi përsëri një barazi votash, atëherë do të kryhet votim i hapur, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 2 të nenit 22.

Neni 25

Procesverbali i mbledhjes

1. Në cdo mbledhje mbahet një procesverbal, ku bëhet një përmbledhje e gjithçkaje që u tha në mbledhje, data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, si dhe forma dhe rezultati i votimeve.
2. Gjatë zhvillimit të mbledhjes, në fund të diskutimeve të cdo pike të rendit të ditës të shkruhet në process verbal procesi votimit, rezultati i tij me votat pro, kundër dhe

abstenime. Pasi ka përfunduar votimi kjo të lexohet nga mbajtësi i procesverbalit për tu ndigjuar nga të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje.

3. Procesverbalit i mbajtur, duhet të nënshkruhet në fund të mbledhjes nga mbajtësi i procesverbalit dhe të gjithë anëtarët e tjere të senatit të pranishëm në mbledhje.

4. Procesverbalit mbahet në një bllok të vecantë duke shkruar në vazhdimësi të faqeve të tij e të mos lejohen faqe bosh si dhe në çdo faqe të shkruhet numri i faqes dhe data e mbledhjes.

Neni 26

Përfshirja në procesverbal e votave “kundër”

Anëtarët e Senatit që votojnë kundër të kërkojnë që të shënohet në procesverbal fakti dhe arsyet e votimit kundër.

Neni 27

Përgatitja dhe paraqitja e materialeve në Mbledhjen e Senatit

1. Kërkesa me gjithë dokumentacionin përkatës që do paraqiten për tu shqyrtuar në Mbledhjen e Senatit nga organizmat sipas nenit 17, pika 1, të kësaj rregullore, kalojnë nëpërmjet protokollit të UST.

2. Organizmi që kërkon të trajtojë çështjet në Senat duhet të paraqesë pranë Kryetarit të Senati kërkesën e shoqëruar me materialet përkatëse dhe me relacion sqarues për çdo çështje që kërkon të trajtojë, duke dhënë të plotë edhe bazën ligjore të kërkesës.

3. Kërkesa drejtuar Senatit me gjithë dokumentacionin përkatës duhet të bëhet me shkrim, të paktën 15 ditë përpara datës së mbledhjes.

Për raste kur ka arsye objektive, kryetari i pranon materialet edhe jashtë këtij afati, por duhet që ato ti shpërndahen anëtarëve të senatit sipas nenit 17 të kësaj rregullore.

4. Materialet për mbledhjen e senatit, të dorëzuara në protokollin e UST, i kalojnë kryesisë së senatit. Kryesia i shqyrton dhe i gjykon nëse janë të plota dhe me pas Kryetari nëpërmjet një shkrese përcjellëse ja shpërndan materialet e mbledhjes të gjithë anëtarëve të senatit. Përgatitja e mbledhjes së kryesisë dhe njoftimi e shpërndarja e materialeve të mbledhjes së Senatit drejtohet nga Rektori.

5. Në rast se kryesia gjykon se materialet nuk janë të plota e konform kësaj rregullore, atëherë Kryetari i Senatit ka të drejtë ti kthejë materialet për përpunim të mëtejshëm.

Neni 28.

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Senati Akademik i UST dhe firmosjes nga Kryetari i Senatit.

KRYETARI I SENATIT

Prof.Dr. AGRON KASA

